



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. G-140/prot.

Tiranë, më 09. 11. 2022

U R D H Ë R

Nr. 584 , Datë 09.11.2022

“PËR  
MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE TË ISH-  
NOTERIT GAZMIR BEGAJ”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, Urdhrit nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

**KONSTATOJ:**

Me Urdhrit nr. 578 datë 24.10.2022, të Ministrit të Drejtësisë, është vendosur heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, noterit Gazmir Begaj, referuar nenit 21, pika 1, gërma “a”, e Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të ish-noterit z. Gazmir Begaj, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e ish noterit, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së thatë dhe të njomë të ish-noterit.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe pas administrimit të shkresës nr. G-132/5 prot., datë 07.11.2022, të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe të email, datë 03.11.2022, të Degës Vendore të Noterisë Vlorë,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të noterit z. Gazmir Begaj, i përbërë nga antarët e mëposhtëm:
  - a.) Znj. Erisa Sulçe, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
  - b.) Znj. Hyri Ramaj, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
  - c.) Znj. Sajmira Hoxha, përfaqësuese nga Dega Vendore e Noterisë Vlorë;

d.) Noteri Ardian Karroqe, përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Ish-noteri, personi i autorizuar prej tij përmes prokurës së posaçme ose personi që ka në ruajtje arkivën i dorëzon regjistrat, aktet noteriale dhe vulat përkatëse Komisionit të ngritur në pikën 1 të këtij urdhri, në ditën dhe orën që është caktuar në marrjen e njoftimit përkatës.
3. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës, merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë antarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.
4. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
5. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noteres, së Degës Vendore të Noterisë Vlorë **znj. Amanda Shanaj**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noterja plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
6. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noteres **znj. Amanda Shanaj**, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Vlorë, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish-noterit Gazmir Begaj.
7. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personit përgjegjës, si dhe ish-noterit Gazmir Begaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

